



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:299400
Datë: 17.01.2022
Numri i dokumentit: 02609519

Ac.nr.1040/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.S. nga P. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I. G. avokat në P., kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK- Qendra Klinike Universitare e Kosovës QKUK, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T.I. , për kompensimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarës së të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.4997/19 të dt.18.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.01.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të autorizuarës së të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës SHSKUK- Qendra Klinike Universitare e Kosovës QKUK, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.4997/19 të dt.18.11.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit, aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses N. S. , nga P. . Ne pikën II të dispozitivit, Detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-Qendra Klinike Universitare e Kosovës, që paditëses në emër të tri pagave të shpërblimit jubilar t’ia paguaj shumën prej 1,275.00€, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë datë 30.12.2019, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 259.00€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Me të njëjtin aktgjykim në pikën III të dispozitivit, refuzohet e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditëses, mbi shumën e gjykuar dhe atë në shumën prej 163.62€.

Kundër këtij aktgjykimi, e autorizuar e të paditurës brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimimi i atakuar dhe të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës si e bazuar dhe padia e paditësit të refuzohet si e pabazë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditëses, me propozim që ankesa të refuzohet ndërsa aktgjykimimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditurës, është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësja përmes të autorizuarit të sajë ka paraqitur padi me datë 30.12.2019, kundër të paditurës, për kompensimin e pagave të shpërblimit jubilar. Në padi, seancat gjyqësore dhe fjalën përfundimtare ka theksuar se, paditësja ka qenë dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, në vendin e punës si infermiere në Klinikën e Hematologjisë në QKUK dhe se e njëjta ka 35 vite përvojë të punës. Paditësja e ka pagën bazë 425.00€. Ka kërkuar nga gjykata që ta obligoj palën e paditur që paditëses t'ia paguaj tri paga të shpërblimit jubilar duke përfshirë kamatën, nga dita parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat dhe vlerësuar ato dhe në fund ka marrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, me detaje të tjera të përshkruara më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, e punësuar sipas kontratës së punës të dt.13.02.2013. Po ashtu gjykata vërtetoj se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga dt.16.17.1984 dhe vazhdon të jetë për kohë të pacaktuar, duke pasur më shumë se 35 vite përvojë të punës tek e paditura. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësja ka në total 35 vite përvojë pune, dhe se të njëjtës nuk i është paguar pagesa për shpërblim jubilar në vlerë të 3 pagave bazë, me tutje si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar. Krejt në fund gjykata ka vendosur edhe lidhur me kamatën dhe shpenzimet e procedurës, duke iu referuar dispozitave ligjore përkatëse.

Këtë gjendje faktike të çështjes, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 17 par.3 pika 3.3 dhe par.4 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, nenit 245, 382 të LMD-së, si dhe nenit 449 dhe 452 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë, ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, kur i referohet faktit jo kontestues në mes palëve se paditësja ka përvojë pune mbi 30 vite, se është me profesion Infermiere në Klinikën e Hematologjisë të QKUK-së, si dhe nuk ka qenë kontestuese as lartësia e pagave gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë. Kështu që me prova dhe fakte jo kontestuese, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa pretendimet ankimore në këtë aspekt, janë të pa baza dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla u refuzuan nga kjo gjykatë.

Sipas Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*”. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”.

Pastaj, me nenin 17 paragraf 3, të Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë të datës 11.06.2018 përcaktohet se: “*Punëtoret shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë 3.1. për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij, 3.2. për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij, 3.3. për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij*”, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni, përcaktohet se: “*Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf*”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të pjesërishëm të kërkesëpadisë së paditëses, duke e detyruar të paditurën që paditëses ti paguaj tri paga për shpërblim jubilar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018, të lidhur dhe nënshkruar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSHSK-së) dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 11.06.2018, ndërsa paditësja ka arritur 30 vite përvojë pune, ndërsa padinë në gjykatë e ka paraqit në kohën kur Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ishte në fuqi dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës ashtu që, kërkesëpadia e paditëses me të drejtë është vendosur nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu me dispozitat e nenit 17 par.4 të KKS të shëndetësisë theksohet se, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar.

Ndërkaq, në situatën ekzistuese nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës, se është dashur të detyrohet Ministria e Shëndetësisë, apo se Qeveria e Kosovës nuk ka nda buxhet për implementimin e kësaj kontrate, sepse Kontrata e tillë ka efektin juridik zbatues dhe duhet të përmbushet nga e paditura. Kështu që në këtë drejtim, pretendimi ankimor, nuk qëndron dhe si i tillë u refuzua nga kjo gjykatë.

Edhe sa i përket Vendimit mbi kamatën, të cilin e ka marrë gjykata e shkallës së parë, të njëjtin gjykata e shkallës së dytë e vlerëson të drejtë dhe të ligjshëm, sepse lartësia e kamatës është caktuar në pajtim me nenin 382 paragraf 1 dhe 2 i LMD-së, (Ligji me nr. 04/L-077 i datës 30.05.2012), i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012. Nga gjithë kjo rezulton se drejtë është aplikuar e edhe e drejta materiale, ndërsa pretendimet ankimore në këtë aspekt nuk janë të bazuara.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat përkatëse të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, nga ai të cilin e ka vendosur gjykata e shkallës së parë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1040/2021, me datë 11.01.2022

Kryetari i kolegjit-gjykatësi
Gëzim Llulluni d.v